

LUMENJTË E ZI TË KOSOVËS



LUMENJTË E ZI TË KOSOVËS

SHKURT 2020, PRISHTINË

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autor: Diana Metushi Krasniqi

Editor: Edita Mustafa Salihi

Faqesja dhe dizajni: envinion

Arti nga ballina: Willy Verginer, "The Boy and the Sea"

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës – Transparency International Kosova dhe përkrahur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e Programit Pro Open. Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

**UJI DHE AJRI,
DY ELEMENTET
THELBËSORE NGA
TË CILAT VARET E
GJITHË JETA, JANË
BËRË SHPORTA
MBETURINASH
GLOBALE,**

Jacques Yves Cousteau

PËRMBAJTJA

HYRJA **8**

SFONDI **10**

PROBLEMI **13**

NDIKIMI I INVESTIMEVE KAPITALE
NË NDOTJEN E UJËRAVE **21**

KONKLUZIONE **26**

REKOMANDIMET **27**

HYRJA

Uji është një nga resurset më të rëndësishme natyrore të çdo vendi, dhe kur ai ndotet, bëhet shkatërrues, jo vetëm për mjedisin, por edhe për shëndetin e njeriut dhe kafshëve dhe habitateve të tyre. Edhe pse qeveritë lokale dhe qendrore në Kosovë bëjnë investime të mëdha çdo vit për të mbajtur ujin e vendit të pastër dhe të sigurt, sistemet e ujit të vendit ende nuk marrin trajtimin e nevojshëm për funksionuar si duhet.

Shikuar nga prizmi i territorit të saj, Kosova duket e pasur me lumenj¹. Në vend janë gjithsej tetë² lumenj me një gjatësi totale të rrjedhës brenda territorit të Kosovës prej 511 kilometrash³, e që derdhen në tre ujëmbledhës detarë⁴, por që lëshojnë territorin e Kosovës brenda 24 orëve nga pika e burimit⁵. Duke qenë që këto burime ujore nuk qëndrojnë në Kosovë për të plotësuar nevojat e qytetarëve të Kosovës për ujë të pijshëm, ujitje, peshkim, turizëm dhe për prodhimin e energjisë elektrike, në shumë vende janë ndërtuar diga për të grumbulluar ujin e përrenjve dhe lumenjve⁶, për ta përdorur atë gjatë stinëve kur reshjet janë shumë të vogla dhe kërkesa është shumë e madhe. Master Plani i ujërave i vitit 1983 parashihte ndërtimin e edhe 20 akumulacioneve të tjera, të cilat deri më sot nuk janë realizuar.

Megjithatë, ndryshimet klimatike të viteve të fundit përbëjnë problem global për mjedisin. Efektet e ndryshimit të klimës shfaqen me një varg dukurish si; ndryshimi i tem-

peraturave, ndryshimi i sasisë së reshjeve, burimeve ujore, frekuencat ekstreme të kushteve klimatike, ndryshimet në ekosisteme dhe biodiversitet, bujqësi, pylltari, shëndet, dëmet ekonomike, etj⁷.

Agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm, e miratuar nga të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015, ofron një plan të përbashkët për paqen dhe prosperitetin për njerëzit dhe planetin, tani dhe në të ardhmen. Në thelb të kësaj agjende janë 17 Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të cilat janë një thirrje urgjente për veprim nga të gjitha vendet, të zhvilluara dhe në zhvillim, për një partneritet global. Ata e pranojnë që përfundimi i varfërisë dhe privimeve të tjera duhet të shkojë paralelisht me strategji që përmirësojnë shëndetin dhe arsimimin, ulin pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike, dhe të gjitha këto ndërkohë që **merren me ndryshimin e klimës dhe punojnë për të ruajtur ujërat dhe pyjet tona**⁸.

Por, si qëndron Kosova në këtë drejtim? Sot, lumenjtë e Kosovës, janë në gjendje të mjerueshme pa një përkujdesje institucionale. Ata janë shndërruar në deponi për hedhjen e mbeturinave inerte dhe në vend-shkarkime të ujërave të zeza dhe të mbetjeve industriale. Ata janë bërë cak i kompanive që nxjerrin zhavorr e që dëmtojnë pellgjet dhe rrjedhën natyrore të tyre, dhe shtëpi të hidrocentraleve që në përditshmëri afektojnë volumn dhe rrjedhat natyrore dhe që fusin këta lumenj në gypa për kilometra të tërë.

1 Resurset ujore t Kosovës, Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës

2 Drini i Bardhë, Sitnica, Lumëbardhi i Pejës, Morava e Binqës, Lepenci, Ereniku, Ibri dhe Lumëbardhi i Prizrenit

3 Ibid

4 Detin e Zi, Detin Adriatik dhe Detin Egje

5 Master Plani i ujërave të Kosovës, 1983

6 Liqeni i Gazivodës, Pridvorci, Batllava, Badovci, Livoçi dhe Radoniqi

7 Global Climate Change, NASA

8 Sustainable Development Goals, United Nations

Kjo analizë fokusohet tek ndotja e lumenjve të Kosovës nga ujërat e zeza. Duke u nisur nga fakti se ajri, uji dhe toka kanë një ndikim direkt në shëndetin publik, ndotja e ujërave në veçanti, vlerësohet si një kërcënim serioz për shëndetin publik.

Me qëllim të trajtimit të këtij problemi, janë konsultuar akterët dhe institucionet relevante, literatura dhe publikimet e ndryshme kombëtare e ndërkombëtare si dhe raportimet e mediave për këtë problematikë.

**“PËR PJESËN MË TË MADHE
TË HISTORISË, NJERIU KA
LUFTUAR NATYRËN PËR TË
MBIJETUAR; NË KËTË SHEKULL
AI KA FILLUAR TË KUPTOJË SE,
PËR TË MBIJETUAR, AI DUHET
TA MBROJË ATË”**

Jacques Yves Cousteau.

SFONDI

Një nga sfidat më të mëdha drejt integritimit evropian është implementimi i standardeve të BE-së për mjedisin⁹. Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, teknologjitë e vjetruara të industrive ekzistuese, menaxhimi i deponive të mbeturinave familjare dhe industriale, shfrytëzimi pa kritere i resurseve natyrore, menaxhimi jo në mënyrë racionale i resurseve natyrore, dhe mungesa e edukimit qytetarë për mbrojtjen dhe trajtimin e drejtë të mjedisit, dhe mos përkushtimi i qeverive në mbrojtjen e këtij sektori¹⁰.

Me qëllim të përafrimit të politikave vendore me vendimin e BE-së¹¹, në vitin 2013, Kosova kishte hartuar strategjinë për mbrojtjen e mjedisit për periudhën 2013 – 2022¹². Një nga sektorët prioritarë¹³ të kësaj strategjie ishte edhe uji. Sipas kësaj strategjie, objektivat kryesore ishin harmonizimi i legjisllacionit me acquis të BE-së, integrimi i mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët, ulja e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, administrimi më i mirë i mbeturinave dhe ujërave dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore. Furnizimi me ujë, trajtimi i ujërave të zeza dhe administrimi i mbeturinave të ngurta komunale konsiderohen prioritetë urgjentë të kësaj strategjie.

Por, sa janë zbatuar këto strategji? Në vitin 2018, Kosova është vlerësuar të ketë pasur 1,795,666¹⁴ banorë të

shpërndarë në 1,469 vendbanime në 38 komuna¹⁵. Sipas të dhënave të paraqitura nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, në 28 komunat të cilat janë nën menaxhimin e kompanive rajonale të ujërave, 77% e tyre posedojnë shërbime të ujërave të ndotura (rrjete të kanalizimit). Megjithatë, vetëm rreth 30% të tyre kanë qasje në sistemet publike të grumbullimit të ujërave të ndotura, ndërsa trajtimi i ujërave të ndotura është vetëm 0.7% e sasisë së përgjithshme¹⁶. Në përgjithësi në Kosovë nuk ka trajtim të ujërave të ndotura. Shkarkimi i tyre zakonisht bëhet direkt në lumenj dhe paraqet një nga ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësore¹⁷. Sipas po të njëjtit raport, edhe përkundër kërkesave të mëdha për investime në këtë sektor, shumat e buxhetuara nga KRU dhe Agjencionet zhvillimore janë tejet të vogla kundrejt nevojave dhe kërkesave aktuale¹⁸. Për më tepër, në Kosovë janë 497 ndërmarrje tregtare prodhuese¹⁹ dhe mbi 5,000 biznese të regjistruara për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve²⁰ të cilat u shërbejnë mbi 340 mijë automjeteve të cilat qarkullojnë në Kosovë²¹. Mbetjet e këtyre veprimtarive, në shumicën e rasteve derdhen në kanalizime, e përfundimisht në lumenjtë tanë.

Sipas Institutit kombëtar të shëndetit Publik të Kosovës, gjatë vitit 2017 sëmundjet si diarreja akute (rritja 2015-

9 Vendimi Nr. 2179/98 / EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian i 24 shtatorit 1998 për rishikimin e programit të politikave dhe veprimeve të Komunitetit Evropian në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm "Drejt qëndrueshmërisë"

10 Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2017, AMMK 2018

11 Vendimi Nr. 2179/98 / EC

12 Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit 2013 – 2022, MMPH 2013

13 Ajri, ndryshimet klimatike, biodiversiteti, ujërat, mjedisi urban dhe mbeturinat

14 Vlerësimi i Popullsisë 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 28 qershor 2019

15 Ibid

16 Raporti i performancës së KRU-2018, ARRU 2019

17 Raporti i performancës së KRU-2016, ARRU 2017

18 Raporti i performancës së KRU-2018, ARRU 2019

19 Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë, TM4 2019, Agjencia e Statistikave të Kosovës

20 Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës

21 Ibid

2017 për rreth 52%), salmonellosis (rritja 2015-2017 për rreth 35%) dhe disa sëmundje ngjitëse kishin shënuar një rritje²² në krahasim me vitet paraprake. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, një faktor i madh në shfaqjen

e diarresë është uji i ndotur²³. Po ashtu edhe salmonella është një bakterie e cila përmes fekaleve bartët në ujë, dhe pastaj shpërndahet tek bio-organizmat e tjerë²⁴.

**NË KOSOVË JANË 497
NDËRMARRJE TREGTARE
PRODHUESE DHE MBI 5,000
BIZNESE TË REGJISTRUARA
PËR MIRËMBAJTJE DHE
RIPARIM TË AUTOMJETEVE TË
CILAT U SHËRBEJNË MBI 340
MIJË AUTOMJETEVE TË CILAT
QARKULLOJNË NË KOSOVË**

²² Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017

²³ Sëmundjet e lidhura me ujin, OBSH (e qasur me 2/18/2020)

²⁴ Salmonella Food Poisoning (Salmonellosis), Melissa Conrad Stöppler, MD, Medicinenet (e qasur me 2/18/2020)



PROBLEMI

Sipas raportit të Bankës Botërore për sigurinë e ujërave të Kosovës²⁵ sfidat kryesore për sektorin e ujit, qëndrojnë në forcimin e kornizës institucionale, veçanërisht për operacionalizimin dhe zbatimin e synimeve të përfshira në kornizën e politikave dhe ligjore, në përmirësimin e bazës së informacionit dhe njohurive për vendimmarrje, dhe zgjerimin e platformës të infrastrukturës për menaxhimin më mirë të burimeve ujore. Më tutje, ky raport ngrit shqetësime lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura.

Në vitin 2010, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës kishte realizuar projektin për përpilimin e Kadastrit të Ndotësve të Ujërave të Kosovës. Ky projekt paraqiste të dhëna shqetësuese, ku ekipet e ekspertëve kishin identifikuar 368²⁶ ndotës të ujërave²⁷. Sipas po të njëjtit, asnjëri ndotës kolektiv nuk kishte pajisje për pastrim apo trajtim mekanik, biologjik ose kimik të ujërave të zeza. Shumica e ndotësve individual janë të lidhur në kanalizimin e qytetit me përjashtim të atyre operatorëve ekonomik që janë jashtë zonës urbane apo në afërsi të ndonjë rrjedhe të ujit.

Sipas këtyre raporteve²⁸ të gjitha pellgjet lumore të Kosovës janë shumë të ndotur, madje ishte raportuar se disa burime ujore ishin të ndotura apo rrezikoheshin nga kontaminime organike si pasojë e mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, rrjeteve e pamirëmbajtura të kanalizimeve, shpyllëzimet e pakontrolluara dhe shfrytëzimet e pakontrolluara të burimeve ujore për agrikulturë.

Lumenjtë kryesorë në rrjedhë të komunave të mëdha dhe industrisë, veçanërisht Sitnica në rrjedhën e prapme të Prishtinës, janë aq të ndotura sa uji nuk mund të përdoret si burim i furnizimit me ujë, dhe në disa vende, madje as për ujitje. Ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësorë janë ujërat e zeza të patrajtuara nga komunat dhe derdhja e mbetjeve industriale²⁹.

Fotografia në vijim tregon vendin e kanalizimit të hapur në kryeqytetin e Prishtinës, respektivisht tek rreth-rrotullimi i rrugës B dhe rrugës Muharrem Fejza, e që derdhet më pastaj në lumin e Sitnicës.

Është shqetësuese se në afërsi prej rreth 10metra të këtij kanalizimi të hapur, në zonën që konsiderohet me zhvillimin më të shpejtë hapësinor, gjenden: një shitore e mishit, tri barnatore dhe disa veprimtari tjera³⁰.

Për më shumë, kjo derdhje e hapur e kanalizimit po shqetëson edhe banorët e zonës në oborret private të të cilëve kalon kjo derdhje³¹. Ky kanalizim i hapur në kryeqytet ka ngritur edhe shqetësime të qytetarëve dhe ekspertëve shëndetësor lidhur me rreziqet e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse dhe shëndetit publik³².

25 Kosovo water security outlook, World Bank Group 2020

26 266 ndotës kolektiv (kanalizime të vendbanimeve me mbi 500 banorët) dhe 102 ndotës të veçantë (individual).

27 Kadastrit të Ndotësve të Ujërave të Kosovës, AMMK 2010

28 Kosovo water security outlook, World Bank Group 2020 dhe Kadastrit të Ndotësve të Ujërave të Kosovës, AMMK 2010

29 Kosovo's looming water security problem, Prishtina Insight 06/11/2017 (e qassur me 17 janar 2020)

30 Banorët e Matit 1, në hall nga kutërbimi i kanalizimit, Gazeta Express, 30 shtator 2019

31 Kanalizimi i pambuluar i shkakton probleme një familjeje në Prishtinë – komuna s'përgjigjet, KOHAnet 24 janar 2020

32 Banorët e "Veternikut" protestojnë për problemet me kanalizim, Ahmeti premtan zgjidhje, KOHAnet 22 shtator 2019

Kadastr i ndotësve të ujërave identifikon 7 ndotës në lumin Prishtevka në komunën e Prishtinës por që për nga volumi dhe përmbajtja e shkarkimeve, mbesin ndotësit më të mëdhenj.



Marrë nga Google Earth, 07 shkurt 2020

Në shkurt të vitit 2020, KDI kishte ngritur edhe shqetësimet e qytetarëve të Graçanicës lidhur me ndotjen e lumit Graçanka.

Sipas raportit për gjendjen e ujërave në Republikën e Kosovës, cilësia e ujit të këtij lumi është në vazhdimësi e ndotur si rezultat i pompimit të ujërave nga minierat e Kishnicës dhe Artanës. Sipas këtij raporti, ky lum ka vlera të larta të përçueshmërisë elektrike dhe të jonit sulfat³³. Për më tutje, i njëjti burim thekson se për vitet 2013-2014-2015 lumi Graçanka është lumi që ka përqendrimin më të lartë të metalit mangan si dhe tejkallime të vlerave të lejuara të metal hekurit.

Fotografia në vijim paraqit vendin ku bashkohen lumi Sitnica dhe lumi Prishtina të shenjuar me një rreth të kuq. Është shqetësuese se me këta lumej rrjedhin ujrë të zeza së bashku me ujërat e lumejve. Nëse shikohet me kujdes, shihet se brenda rrethit të kuq janë evidentuar ujërat e turbullta dhe ujërat e zeza.



Foto @KDI, 20 shkurt 2020

33 RAPORT PËR GJENDJEN E UJËRAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, AMMK, 2015



Në fotografinë në vijim është paraqitur vendi, ku në afërsi të lumit Sitnica është deponia e hirit në Mirash dhe ujërat industriale të grumbulluara nga kjo deponi. Nga ana tjetër, në afërsi të lumit Sitnica gjendet vendbanimi. Çshtë shqetësues fakti se ujërat industriale të kësaj deponie, së

bashku me ujërat e zeza të vendbanimit, derdhen në lumin Sitnica të patrajtuara. Gjithashtu, është shqetësuese edhe se uji i ndotur nga lumit Sitnica drejt për së drejti ndikon në ndotjen e ujit të puseve të vendbanimit.





Në vazhdim është paraqitur vendi ku në afërsi të lumit Sitnica është deponia e mbeturinave komunale në Mirash dhe ujërat e zeza të grumbulluara nga kjo deponi. Nga ana tjetër, në afërsi të lumit Sitnica është i ndërtuar një kanal i cili zgjatet prej deponisë së mbeturinave deri te vetë lumi

Sitnica i cili është i mbushur me ujra të ndotura nga kjo deponi. Shqetësim i veçant në këtë rast është kur shikohet se si uji i ndotur (i turbulluar) rrjedhë së bashku me ujin e lumit Sitnica.



Në pamjen e rradhës është paraqitur vendi ku në afërsi të lumit Sitnica është deponia e hirit të TC Kosova B dhe ujërat industriale të grumbulluara përreth deponisë. Nga ana veriore e deponisë së hirit është një kanal me ujëra të zeza që vijnë nga fshati Plemetin dhe ujërat industriale që

vijnë nga deponia e hirit të Kosovës B. Shqetësimet lidhen me ndikimin e drejtpërdrejtë të këtyre ujërave të zeza në pusët (bunarët), një pjesë e të cilëve banorët e këtij lokaliteti i shfrytëzojnë për pije.





Një gjendje e njëjtë është edhe tek bashkimi i Lumit Sitnica dhe Lumi Llap, e paraqitur në vijim. Në afërsi të këtyre

lumejve janë të pranishme vendbanimet që i derdhin ujërat e zeza drejt për drejt në lumin Llap.



Por këto probleme nuk janë vetëm në pellgun e Ibrit, respektivisht me lumin e Sitnicës.

Problematika e rrjetit të kanalizimit, si një ndër shqetësimet e mbarë vendit, nuk e ka kursyer as lumin Mirusha, në komunën e Malishevës. **Pavarësisht faktit që ky burim që në vitin 2012 nga Qeveria është i shpallur si zonë e veçantë natyrore, trajtimi ndaj tij nuk përkon me vlerësimin që i është bërë. Derdhja e kanalizimeve të 11 fshatrave (Bellanicë, Temeqinë, Bubël, Panorc, Rud, Turjakë, Mirushë, Lubizhdë, Banjë, Damanek dhe Llapqevë) është një ngarkesë e madhe për lumin.** Sipas një analize hapësinore për këtë komunë, të realizuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor, çdo banor i Malishevës shkarkon 16.46m^3 /vit ujëra të zeza. "Zona urbane e Malisheva me 3300 banorë shkarkon 1.8 l ujë/sec , ose 54318 m^3 ujëra të pa trajtuara në lum brenda vitit, pa llogaritur këtu objektet afariste dhe bizneset", thuhet në këtë analizë.

Në korrik të vitit 2018 kishte pasur një ngordhje masive të peshqve në këtë lum, por që shkaktarët, sipas MMPH, mbesin të pa identifikuar.



Foto @Kallxo.com, 25.7.2019

E njëjta situatë e ngordhjeve misterioze kishte ndodhur edhe në vitin 2019. **Sipas udhëheqësve të Komunës së Malishevës ngordhja e parë ka ardhur si pasojë e pastrimit të tubave të kompanisë së pastrimit, dhe hedhjes së mbetjeve në lum, dhe shqetësimet mbesin tek kanalizimet me përbërje të detergjenteve për pastrime të nevojave familjare. Ndërsa, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës në reagimin e tyre ndaj këtyre ngjarjeve thonë se ngordhja masive e peshqëve është një indikator për ndotjen e mjedisit dhe ujit, dhe u bënë thirrje qytetarëve që ta ruajnë mjedisin.**

KDI gjatë hulumtimit të saj ka kërkuar nga komuna që të ketë qasje në dokumentet komunale buxhetore që të shohin se si planifikon komuna të zgjidhë problemin e ndotjes së lumit Mirusha. Nga dokumentet e siguruar (Planifikimi i prokurimit 2019 dhe Material për buxhetin për 2020) është vërejtur që nuk është anashkaluar çështja e kanalizimeve të disa fshatrave. Ndërsa për rregullimin e shtratit të lumit Mirusha nuk është dhënë prioritet i lartë. Konkretisht, kategoria 46 e planifikimit të prokurimit për vitin 2019 nga KK Malishevë, paraqet 230K euro të ndara për punimin e kanalizimeve, që përbën 7.5% të vlerës totale të buxhetit.



Foto @Kallxo.com, 25.7.2019

Këtu përfshihen fshtrat: Tërpezë, Marali, Pagarushë, Mali-shevë, Carrallukë, Banjë, vërmicë, Mleqan, Bubavec, Kijevë, Llazicë, Guriq, Lladrovç, Janqist, Shkozë, Panorc, Kërvasari, Burim, Astrazup, Bardh, Gurbardh, Balince, Gullbovc, Rud, Shkarashnik. Kategoria 44 e këtij buxheti tregon për ndarje të vetëm 2 mijë euro për pastrim të lumit Mirusha.

Në vitin 2015, në lumin Morava kishte pasur një ngordhje masive të peshqëve. Sipas Inspektoratit të MMPH-së, bashkë me Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), të cilët kishin dalur në terren për të konstatuar gjendjen, dhe IHMK kishte bërë analizën e cilësisë së ujit të lumit, analizat laboratorike kishin treguar se nuk kishte vlera të ngritura të ndotjes. Megjithatë, sipas gjyqimeve të ekspertëve, **për shkak të rënies së sasisë së ujit, është ngritur përqendrimi i ndotësve, kryesisht të ujërave të zeza të shkarkuara qoftë nga amvisëritë qoftë nga industritë, e që kishte rezultuar në ngordhjen e peshqve**³⁴.

Të njëjtin fat kishin pasur edhe peshqit e Lepencit. Në maj të vitit 2019 kishte pasur një ngordhje masive të peshqve në Lepenc. **Pas inspektimit nga inspektorët komunal, ishte konstatuar se kjo ngordhje kishte ardhur si pasojë e hedhjes së materialeve ndotëse, me përmbajtje toksike, në dy lokacione, nga një ndërmarrës privat**³⁵.

Lepenci për një kohë të gjatë është shndërruar në një pikë atakimi të ndotësve të mjedisit. Sipas kryetarit Rufki Suma, gjatë punimeve të përditshme në autostradën Arbën Xhaferi, i janë shkaktuar shumë probleme qytetarëve si "pamundësia për t'u kyçur në pronat e tyre, dëmtime të shtëpive, **ndotje dhe degradim i ambientit**, zënie e shumë kanalizimeve atmosferike, pengimi në realizimin e projekteve komunale për shkak të punimeve të tyre, prishja e qetësisë publike nga zhurma, jo vetëm gjatë ditës, por edhe gjatë natës"³⁶.



Me një situatë e tillë e rëndë ishte ballafaquar edhe komuna e Prizrenit, ku në fshatin Dobrajë në gusht të vitit 2019, kishin ngordhur dy lopë të cilat kishin pirë ujë në lumin Lumbardh, ku pak ditë më parë kishin ngordhur peshqit. Në këtë lum dyshohet se për shkak të ujërave të ndotura kishin ngordhur rreth 12 ton peshq³⁷.

34 Lumenjtë e Kosovës, më të ndotur në rajon, Albinfo.ch, 5 tetor 2015

35 Mësohet se kush po i mbyl peshqit në Lepenc, Gazeta Blic, qershor 2019

36 Komuna e Hanit të Elezit dhe 'Bechtel-Enka' nuk merren vesh për punimet në autostradë, Gazeta Ndërtimi, 11 tetor 2018

37 Skandaloze: lopët ngordhin pasi pinë ujë në Lumbardh, Insajderi, 1 shtator 2019

NDIKIMI I INVESTIMEVE KAPITALE NË NDOTJEN E UJËRAVE

Gjatë viteve 2017-2019, Institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës kishin nënshkruar 326 kontrata për investime publike në ndërtimin dhe riparimin e kanalizimeve në Kosovë³⁸. Vlera monetare e këtyre kontratave ishte afër 43 milion Euro.

AUTORITETI KONTRAKTUES	VLERA E PARASHIKUAR	AUTORITETI KONTRAKTUES	VLERA E PARASHIKUAR
"QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE" NË PRISHTINË	€ 9,900.00	KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË	€ 363,397.25
K.K. SKENDERAJ	€ 2,320,000.00	KUVENDI KOMUNAL- GJILAN	€ 3,110,888.26
Komp. Rajon Ujësjiellësit "Hidromorava" SH.A.	€ 720,000.00	KUVENDI KOMUNAL I KLINËS	€ 1,296,775.20
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL "PRISHTINA" SH.A.	€ 131,000.00	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT	€ 4,514,557.11
KOMUNA E GJAKOVËS	€ 1,026,512.95	KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ	€ 58,200.00
KOMUNA E ISTOGUT	€ 745,825.00	KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN	€ 929,508.00
KOMUNA E JUNIKUT	€ 49,340.00	KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE	€ 1,324,660.70
KOMUNA E KAMENICËS	€ 351,741.41	KUVENDI KOMUNAL MITROVICË	€ 840,000.00
KOMUNA E KLLOKOTIT	€ 30,000.00	KUVENDI KOMUNAL NOVO BRDO	€ 131,829.00
KOMUNA E MAMUSHËS	€ 517,535.10	KUVENDI KOMUNAL VITI	€ 415,853.18
KOMUNA E PEJES	€ 353,270.66	KUVENDI KOMUNAL ZVEÇAN	€ 470,000.00
KOMUNA E PODUJEVËS	€ 2,878,864.28	KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN	€ 426,970.00

38 E-Prokurimi (njoftimet kontratat e nënshkruara për kanalizime 01.01.2017 – 31.12.2019)

|||||

Viti	Institucioni publik	Projekti	Vlera e buxhetuar
2019	Autoriteti Rajonal i Pelgjeve Lumore	Impianti per ujera te zeza ne Komunen e Prishtines	€ 3,000,548.00
		Impianti per ujera te zeza ne Komunen e Prishtines	€ 2,500,000.00
		Ndertimi i impianteve per trajtimin e ujerave te zeza-Ferizaj, Gjilan, Mitrovice	€ 5,000,000.00
2019	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërve të zeza - Ferizaj	€ 1,125,000.00
2019	Podujeve	Impianti per trajtimin e ujerave te zeza - Podujevë	€ 5,349,000.00
2019	Shtime	Impianti per trajtimin e ujerave te zeza - Shtime	€ 2,385,000.00
2019	Fushë Kosovë	Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e ujërave të zeza	€ 120,000.00
2019	Prizren	Ndërtimi i impiantit në lumin Toplluha	€ 1,000,000.00
2019	Pejë	Participim me Kfë-në Ndërtimi i impiantit të ujërave të zaza në Gllaviçicë	€ 685,000.00
		Ndërtimi i impianteve nëpër fshatra	€ 3,600,000.00
2019	Vushtrri	Ndërtimi i impiantit	€ 300,000.00
2019	Kaçanik	Ndertimi i impiantit per trajtimin e ujrave të zeza	€ 202,704.00

TOTAL 2019 € 25,267,252.00

Viti	Institucioni publik	Projekti	Vlera e buxhetuar
2018	MMPH	Impianti per ujera te zeza ne Komunen e Prishtines	€ 3,000,000.00
2018	Pejë	Participim me Kfë-në Ndërtimi i impiantit të ujërave të zaza në Gllaviçicë	€ 1,370,000.00
2018	Vushtrri	Ndërtimi i impiantit	€ 25,000.00
2018	MMPH	Impianti per ujera te zeza ne Komunen e Prishtines	€ 2,700,000.00

TOTAL 2018 € 7,095,000.00

TOTAL BUXHETI PËR NDËRTIM TË IMPIANTEVE 32,362,252 EURO

|||||

Megjithatë, edhe pse kishte një fond të konsiderueshëm për investime në trajtimin dhe përmirësimin e gjendjes së ujërave në Kosovë, gjatë kësaj periudhe⁴⁰ ishin dhënë vetëm 8 kontrata⁴¹ për ndërtimin e impianteve në vlerë prej 2.2 milion Euro, apo rreth 5% të vlerës së buxhetuar.

Autoriteti kontraktues	Lënda e prokurimit / grupi	Vlera e parashikuar
CDI	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Volljakë - Komuna e Klinës-RITENDER	€ 285,000.00
MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	"Impianti për trajtimin ujerave te zeza ITUZ, ne bllokun urban" Prishtine e Re	€ 700,000.00
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	"Ndërtimi i kanalizimit të Impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe industriale të Parkut të Biznesit në Drenas dhe Zonës Industriale"	€ 28,388.44
CDI	"Ndërtimi i 1 (një) Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Fshatin 'Orllan' në Komunën e Podujevës: Faza 2 nga 2." - RITENDER	€ 450,000.00
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	"Investime shtesë në lagunën e Impiantit të PBD-së"	€ 15,517.70
CDI	"Ndërtimi i 1 (një) Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Fshatin 'Orllan' në Komunën e Podujevës: Faza 1 nga 2."	€ 350,000.00
CDI	Ndërtimi i 1 (një) Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Fshatin 'Marmull' në Komunën e Gjakovës.	€ 130,000.00
MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	Impianti per trajtimin e ujerave te zeza	€ 300,000.00
Total kontrata (2017-2019) për ndërtimin e impianteve		€ 2,258,906.14

40 (2017-2019)

41 E-Prokurimi (njoftimet kontratat e nënshkruara për impiante për trajtimin e ujërave të ndotura 01.01.2017 – 31.12.2019)

Përderisa janë dhënë 326 kontrata për ndërtim të kanalizimeve në vlerë prej 43 milion, janë dhënë vetëm 8 kontrata për trajtim të ujërave të ndotura në vlerë prej 2.2 milion Euro.

Për më shumë, në bazë të informatave të pranuar nga institucionet publike⁴², edhe pse një numër i madh i projekteve të sipër cekura kishin pasur një vlerësim të ndikimit në mjedis, inspektoratet e mjedisit nuk kishin bërë inspektime për të matur nivelin e ndotjes pas funksionalizimit të kanalizimit, respektivisht nivelin e ndikimit mjedisor. Gjatë analizimit të kornizës ligjore, është gjetur që ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis parasheh zhvillimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e Impiantet e trajtimit të ujërave urbane të shkarkuara me kapacitet ekuivalent ose më të madh, për njëqindmijë (100.000) banorë.

Edhe pse qëllimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është parandalimi dhe menaxhimi i ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, fatkeqësisht ky ligj nuk po gjen implementim të mirëfilltë, për aq më keq mu nga institucionet publike.

Neni 3.1 i Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis identifikon, përshkruan dhe vlerëson në mënyrë të duhur rrethanat e secilit rast individual, efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndonjë projekti në (3.1.1) njeriun, botën bimore dhe shtazore, dhe (3.1.2) tokë, ujë, ajër, klimë dhe peisazh⁴³. Megjithëse raportet vendore dhe ndërkombëtare shpërfaqin shqetësime konkrete lidhur me ndotjen mjedisore dhe efektet në shëndetin e njeriut dhe faunës në lumenjtë e Kosovës nga derdhja e kanalizimeve, ky ligj nuk parasheh një vlerësim mjedisor për këtë kategori të investimeve kapitale.

42 Pytësor i datës 20/25/2020

43 Ligji Nr. 03/ L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

KONKLUZION

Viteve të fundit, ndotja e lumenjve është manifestuar me ngordhjet masive të peshqve, e madje edhe të bagëtisë, gjatë viteve të fundit.

Edhe pse ndotësit më të mëdhenj industrial të lumenjve në Kosovë konsiderohen Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), "Ferronikeli" dhe "Sharrcem", minierat e Trepçës, Kishnicës e Artanës, kanalizimet kolektive përbëjnë një nga ndotësit kryesor të lumenjve.

Ujërat e ndotura përveç se kjo ndotje rrezikon florën dhe faunën, ato rrezikojnë edhe shëndetin e qytetarëve të Kosovës, sidomos duke pasur parasysh që një pjesë e madhe e zonave rurale ende furnizohen me ujë të pijshëm dhe amvisëri nga puset, të cilat mbushen nga këto rrjedhje të ndotura, dhe për aq më shumë nuk inspektohet cilësia e ujit të këtyre puseve. Sipas statistikave të Institutit kombëtar të shëndetit Publik të Kosovës të vitit 2017, është shqetësuese rritja e statistikave të sëmundjeve të cilat barten nga ujërat dhe toka e ndotur si Diarrea dhe Salmonella.

Gjatë viteve 2017-2019, institucionet publike të Kosovës kishin kontraktuar 326 projekte për ndërtimin e kanalizimeve, të cilat derdhen në të gjithë lumenjtë e Kosovës. Ndërkohë që, përkundër burimeve financiare që kishin pasur në dispozicion, institucionet kishin kontraktuar vetëm XX projekte për ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza (apo vetëm 5% të projekteve të planifikuara).

Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis nuk parasheh dispozita të cilat kërkojnë vlerësime të tilla për investimet kapitale në rrjetet e kanalizimeve, përkundër që ato përbëjnë ndotësit kryesorë të lumenjve tonë.

REKOMANDIMET

Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit, si bartëse e përgjegjësiwe paraprakisht të Ministrisë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duhet që:

- Të adresojë me prioritet sfidat në realizimin e të gjitha projekteve për impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura;
- Të rrisë numrin e inspektimeve në terren (të ndotësve kolektiv dhe individual) në mënyrë që të parandalohen dhe gjobiten kontaminimet e ujërave që përbëjnë rrezik për shëndetin publik dhe floërën e faunën;
- Të inspektoj burimet e ujërave të pijes dhe amvisërisë (puset) në zonat që gjenden përreth lumenjve me qëllim të kontrollit të cilësisë së ujit dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve për shkak të ujit dhe tokës së ndotur.
- Të përditësojë legjislacionin aktual, dhe t'a bëjë obligativ vlerësimin e ndikimit në mjedis edhe për investimet kapitale siç janë rrjetet e kanalizimit. Në vlerësim i killë do të ishte një vegël e mirë për të monitoruar ndotjen dhe krijuar mekanizmat mbrojtës ndaj ndotjeve të tilla.

THIRR

**0800
77 777**

RAPORTO KORRUPSIONIN

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.